

Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Besa Ademi, në përputhje me nenin 119 të Rregullores gjyqësore ("Gazeta zyrtare e RM" nr.66/13 dhe 114/14) dhe nenit 88 paragrafi (1) dhe (2) të Ligjit për gjykatat ("Gazeta zyrtare e RMV" nr.58/06...96/19), miratoi këtë:

## **REND SHTËPIAK**

### **Neni 1**

Me rendin shtëpiak përcaktohet mënyra e shfrytëzimit të hapësirave punuese, mbajtja e rendit dhe higjienës, masat e nevojshme të sigurisë së hapësirave dhe masa të tjera për rruajtjen e mjeteve të punës dhe të lëndëve të cilat gjenden në Gjykatën, si dhe obligimet e policisë gjyqësore lidhur me kujdesin e sigurisë së ndërtesës.

Rendi shtëpiak shënohet për shkak të realizimit të kushteve optimale të punës së të punësuarve në Gjykatën dhe me qëllim për qasje më të lehtë të qytetarëve në realizimin e të drejtave të tyre në Gjykatën.

### **Neni 2**

Rregullat e rendit shtëpiak kanë të bëjnë dhe janë të detyrueshme për të punësuarit në ndërtesën gjyqësore edhe atë, të punësuarit në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për palët, për të autorizuarit e tyre, përfaqësuesit dhe mbrojtësit e tyre, si dhe pjesëtarë tjerë të procedurës gjyqësore, si dhe për të gjithë personat tjerë të cilët për çdo lloj rasti janë të përfshirë në ndërtesën gjyqësore, në parkingun e Gjykatës dhe në ndonjë hapësirë tjetër funksionale që i takon Gjykatës.

### **Neni 3**

Rendi i brendshëm i ndërtesës gjyqësore i përfshin:

- mënyrën e shfrytëzimit të orarit të punës në Gjykatën
- mënyrën e shfrytëzimit të hapësirave punuese dhe hapësirave tjera të Gjykatës
- mënyrën e shfrytëzimit të hapësirave rreth ndërtesës së Gjykatës
- hyrjen dhe qëndrimin në ndërtesën gjyqësore
- sigurimin e ndërtesës së Gjykatës dhe personat në të
- sjelljen e të punësuarve në Gjykatë dhe
- fotografimi, audio dhe video incizimi.

### **MËNYRA E SHFRYTËZIMIT TË ORARIT TË PUNËS NË GJYKATË**

### **Neni 4**

Orari i punës në Gjykatë është nga ora 07,30 deri në orën 15,30.

Pauza gjatë orarit të punës shfrytëzohet nga ora 11,00 deri në orën 11,30.

Periodha kohore e punës me palë në sportelet gjyqësore është nga ora 8,30 deri në orën 14,00.

Orari i punës në sportelin pranues për palët është nga ora 07,30 deri në orën 15,30.

Të punësuarit në Gjykatë duhet t'i përmbahen orarit të punës dhe të jenë nëpër vendet e tyre të punës pa qëndruar pa nevojë në hapësirat tjera të Gjykatës.

Të punësuarit janë të obliguar që gjatë ardhjes në punë dhe pas kryerjes së punës, si dhe gjatë shfrytëzimit të pauzës, daljen zyrtare dhe mungesat e lejuara gjatë ditës punuese, t'i evidentojnë me kartelën për evidencë elektronike të orarit të punës.

Mungesa gjatë ditës së punës mund të shfrytëzohet me lejen e marrë paraprakisht nga administrata gjyqësore.

Pas orarit të punës në ndërtesën gjyqësore qëndrojnë të punësuarit të cilët në atë kohë i realizojnë obligimet e tyre punuese (punëtorët e higjienës dhe policët gjyqësor), kurse të punësuarit tjerë në përputhje me orarin e kujdestarisë dhe/ose nevoja tjera të jashtëzakonshme për realizimin e punëve.

Realizimi i obligimeve të rregullta punuese jashtë orarit të punës dhe ditëve jo pune, të punësuarit në Gjykatë i realizojnë me lejen e marrë paraprakisht nga administrata gjyqësore.

Jashtë orarit të punës, të punësuarit mund të hynë në ndërtesën gjyqësore me paraqitjen paraprake në policinë gjyqësore, që është e obliguar ta evidentojë kohën e hyrjes dhe daljen dhe shkaqet e hyrjes.

## **MËNYRA E SHFRYTËZIMIT TË HAPËSIRAVE PUNUESE DHE HAPËSIRAVE TJERA DHE MJETET PËR PUNË NË GJYKATË**

### **Neni 5**

Të punësuarit obligohen të shfrytëzojnë hapësirat dhe mjetet e punës me kujdes si kursimtar i mirë.

Hapësirat punuese, korridoret, zyrat e pritjes dhe hapësirat tjera të ndërtesës gjyqësore duhet doemos të jenë të rregulluara, të pastra, të përgatitura me mjete higjienike dhe me mjete të shënuara zjarrfikëse.

Në sallat e gjykimit, në sportelet gjyqësore dhe në hapësirat tjera zyrtare është e ndaluar kryerja e aktiviteteve dhe mbajtja e lëndëve të cilat nuk janë në funksion të realizimit të veprimtarisë themelore të Gjykatës.

Në hapësirat punuese dhe në korridoret e Gjykatës nuk është e lejuar të bëhet zhurmë e panevojshme, bisedë e zëshme dhe e qeshur të cilat do të prishnin procesin punues.

Nuk është e lejuar nxjerrja e mjeteve themelore dhe inventar nga ndërtesa gjyqësore përveç në rast të riparimit dhe servisimit, me lejin e administratës gjyqësore.

Nuk është i lejuar përdorimi i materialit zyrtar për nevoja private.

Automjetet zyrtare të Gjykatës mund të shfrytëzohen vetëm për nevoja zyrtare, me leje paraprake nga Kryetarja e Gjykatës.

### **Neni 6**

Hapësirat në Gjykatë, gjatë orarit të punës mbyllen kur në to nuk janë të punësuarit në Gjykatë.

Pas kryerjes së orarit të punës lëndët, materialet zyrtare, mjetet zyrtare, objekte tjera me vlerë më të madhe, vulat dhe vulat katrore mbyllen me çelës.

Të gjitha hapësirat doemos të kenë çelësa rezerva të cilat rruhen tek policia gjyqësore.

### **Neni 7**

Të punësuarit janë të obliguar që para lëshimit të hapësirave punuese t'i kontrollojnë nëse janë dritaret e mbyllura, dritat e kyçura, mjetet dhe aparatet elektrike.

Pjesëtarët e policisë gjyqësore pas orarit të punës obligohen të bëjnë kontroll të rregullt të hapësirave dhe të gjendjes në dhe rreth ndërtesës gjyqësore.

### **Neni 8**

Në tabelën e shpalljes së Gjykatës shkruhen vendime gjyqësore dhe njoftime të dedikuara për palët, si dhe informacione nga kompetenca e Gjykatës.

Në tabelën e shpalljes dhe në pjesë të tjera të ndërtesës gjyqësore nuk është e lejuar shkrimi i shpalljeve private ose oferta nga persona fizik ose juridik, përveç me lejen e Kryetares së Gjykatës.

## HYRJA DHE QËNDRIMI NË NDËRTESEN E GJYKATËS

### Neni 9

Ndërtesa e Gjykatës ka 3 (tre) hyrje:

- 2 – dy hyrje nga përdhesja – hyrje për palë dhe hyrje për të punësuarit dhe hyrje nga garazhi
- Hyrja nga garazhi

Për rregullin e hyrjeve në Gjykatë, përgjegjëse është policia gjyqësore, e cila është e obliguar për të siguruar kalimin pa pengesë për të punësuarit, për palët dhe për persona tjerë të cilët hyjnë dhe dalin nga ndërtesa gjyqësore.

Për hyrje dhe dalje nga ndërtesa gjyqësore, të punësuarit, palët dhe persona të tjerë e shfrytëzojnë njëhën hyrje nga përdhesja dhe hyrjen e garazhit.

Gjatë hyrjes së palëve dhe personave tjerë, policia gjyqësore është e obliguar që të bëjë legjitimin me shikim në dokumentacionet e tyre personale, dhe nëse bëhet fjalë për person pa ftesë për seancë, evidentohet hyrja dhe shkaku për hyrjen për të cilën futet në ndërtesën gjyqësore.

Nëse bëhet fjalë për palë ose persona tjerë që janë thërritur në seancë, policia gjyqësore është e obliguar të bëjë shikimin në ftesat dhe ti udhëzojë në vendin për ku janë të thërritur.

Nëse bëhet fjalë për palë përkatësisht person që kërkon pranim te Kryetari i Gjykatës, te ndonjë gjyqtar ose te administratori gjyqësor ose te ndonjë i punësuar tjetër, anëtari i policisë gjyqësore është i obliguar ta paralajmërojë palën, përkatësisht personin dhe ta udhëzojë nëse është lejuar pranimi.

Personave që janë në gjendje të alkoolizuar dhe nën ndikim të narkotikëve, policia gjyqësore nuk do t'i lejojë hyrjen në ndërtesën gjyqësore.

Ndalohe mbajtja e palëve dhe personave tjerë pas përfundimit të nevojave nga prezenca e tyre në Gjykatë.

Në sallat e gjyqimit dhe në sallën e Seancave të Përgjithshme, si dhe në hapësirat për shikimin e shkresave, ndalohe përdorimi i telefonave celular.

### Neni 10

Në korridoret dhe në sallat e ndërtesës gjyqësore nuk lejohet konsumimi i ushqimit dhe të pijeve alkoolike.

Nëpunësve gjyqësorë të sporteleve nuk u lejohet konsumimi i ushqimit gjatë orarit të punës me palë.

Pirja e duhanit në ndërtesë është e ndaluar.

## MËNYRA E SHFRYTËZIMIT TË HAPËSIRAVE RRETH NDËRTESES SË GJYKATËS

### Neni 11

Hapësira rreth ndërtesës së Gjykatës i përfshin: shkallët, hapësira nga hyrja kryesore e ndërtesës së gjykatës, hapësira ndër ndërtesën ku janë të parkuara automjetet zyrtare të Gjykatës, automjetet e gjyqtarëve dhe të punësuarve.

Për parkimin e automjeteve zyrtare të Gjykatës shfrytëzohet garazhi në Gjykatë.

Për respektimin e regjimit të vendosur për parkimin e automjeteve në pajtim me lejen nga Kryetari i Gjykatës, kujdeset policia gjyqësore.

## **SIGURIMI I NDËRTESESË SË GJYKATËS DHE PERSONAVE NË TË**

### **Neni 12**

Mbikëqyrjen mbi qarkullimin e personave që qëndrojnë në ndërtesën gjyqësore e bëjnë anëtarët e policisë gjyqësore përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë dhe përmes sistemit për video mbikëqyrje.

Policia gjyqësore e mban rendin në Gjykatë, e mbron jetën e të gjithë të pranishmëve në ndërtesën gjyqësore dhe në hapësirën rreth ndërtesës së Gjykatës.

Pas mbarimit të orarit të punës për sigurimin e ndërtesës dhe pronën e Gjykatës përgjigjet policia gjyqësore.

Policia gjyqësore gjatë hyrjes së palëve dhe personave tjerë në Gjykatë mund të bëjë kontrollin dhe bastisjen e personave dhe kontrollin e lëndëve që ata i sjellin në Gjykatë.

Ndalohet sjellja e ndonjë arme zjarri ose ndonjë lloj arme tjetër në Gjykatë. Personat që mbajnë armë zyrtare gjatë hyrjes në ndërtesën gjyqësore obligohen që ta dorëzojnë te policia gjyqësore.

Nëse pala apo ndonjë person tjetër e prish rendin dhe qetësinë në ndërtesën gjyqësore, policia gjyqësore do të ndërmer masa adekuate.

Ndalohet qëndrimi i të punësuarve, palëve dhe personave tjerë në hapësirat e anëtarëve të policisë gjyqësore.

## **SJELLJA E TË PUNËSUARVE NË GJYKATË**

### **Neni 13**

Të punësuarit në Gjykatë obligohen që në marrëdhëniet ndërmjet tyre të veprojnë me kujdes dhe respekt, të bashkëpunojnë dhe të kontribuojnë në avancimin e marrëdhënieve profesionale dhe atmosferës punuese, duke ju shmangur veprimeve të cilat do të kishin pasoja dëmi për reputacionin e Gjykatës.

Të punësuarit në Gjykatë obligohen që ndaj palëve dhe ndaj personave tjerë që vijnë në Gjykatë të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe në mënyrë profesionale, duke marrë parasysh që t'ju sigurojë qasjen më të lehtë në realizimin e të drejtave të tyre.

Të punësuarve të Gjykatës nuk u lejohet që të komentojnë me palët për rregullsitë dhe rrjedhjen e procedurës gjyqësore, vendimin gjyqësor dhe rezultatin e kontestit.

## **Rregullat e veshjes**

### **Neni 14**

Palët dhe personat tjerë që hyjnë në ndërtesën e Gjykatës duhet të kenë veshje përkatëse dhe të denjë, në të kundërtën nuk do t'ju lejohet hyrja në ndërtesën gjyqësore.

Të punësuarit në Gjykatë obligohen të jenë të veshur në mënyrë të denjë dhe në mënyrë adekuate pune. Me veshjen e tyre nuk duhet të japin përshtypje të padenjë dhe ta prishin reputacionin e Gjykatës. Të punësuarve nuk u lejohet mbajtja e: veshjeve sportive-tuta, pantallona shtrirje (hellanka) dhe xhinse të ngushta në çizme të gjata, funde të shkurtra, pantallona mbi gjunjët, dekolte të thella, ndërsa supet dhe beli duhet të jenë të mbuluara.

## **FOTOGRAFIMI, AUDIO DHE VIDEO INCIZIMI**

### **Neni 15**

Fotografimi, audio dhe video incizimi në ndërtesën gjyqësore mund të bëhet vetëm me lejen me shkrim nga Kryetari i Gjykatës.

## **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 16**

Rendi shtëpiak publikohet në faqen zyrtare, ju është dorëzuar të punësuarve në mënyrë elektronike, është në dispozicion në “dosjen e përbashkët” dhe është shënuar në hapësirat e Gjykatës.

### **Neni 17**

Mosrespektimi i dispozitave të rendit shtëpiak nga të punësuarit në Gjykatë, tërheq përgjegjësi disiplinore, sipas Ligjit.

### **Neni 18**

Rendi shtëpiak hyn në fuqi nga dita e miratimit.

**ПРЕТСЕДАТЕЛ НА ВРХОВНИОТ СУД НА РЕПУБЛИКА  
СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
KRYETARJA E GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË  
MAQEDONISË SË VERIUT**

**Besa Ademi**